



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 20 (81) Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 29/04/2021

VENDIM
Nr.20, date 29 /04/2021

PËR

**RAPORTIN VJETOR TE SHFRYTEZIMIT TE DIGAVE TE ADMINISTRUARA NGA
BASHKIA TIRANE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 32, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29.04.2021 mori në shqyrtim Raportin Vjetor të shfrytëzimit të digave të administruara nga Bashkia Tirane. Bazuar në Raportin e paraqitur, gjendjen aktuale të digave perkates, Rreziqeve të mundshme gjatë shfrytëzimit të digave të Bovilles, Kasharit, Farkes, liqenit artificial të Tiranës si dhe legjislacionit të mesiperm, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Bashkisë Tiranë

- Plotesimin e dosjeve teknike për 38 Digat e mëdha të Bashkisë Tirane
- Instalimin e sistemeve të Monitorimit të digave dhe sistemeve të Alarmit në digat e Liqenit Artificial, Bovilles, Farkes dhe Kasharit brenda vitit 2021
- Përgatitjen e Planeve të Gadishmerise në rastet e emergjencave civile dhe hartat e permbytjeve në pjesën e poshtme të digave të Bovilles, Farkes, Kasharit dhe liqenit artificial të Tiranës sipas legjislacionit të mesiperm dhe Udhezimeve të KKDM brenda muajit Nendor 2021.
- Përgatitjen dhe dorëzimin në KKDM të studimit për përcaktimin e valës vershuese dhe hartat perkatese të permbytjeve sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe Vendimit Nr. 3, datë 19.04.2018 të KKDM
- Kryerjen e matjeve të depozitimeve të materialeve të ngurta në rezervuarët e digave të liqenit artificial të Tiranës, Farkes dhe Kasharit (Matjet batimetrike të volumeve të rezervuarëve) sipas kërkesave të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", neni 30
- Kryerjen e Rehabilitimeve të nevojshme në digën e Liqenit artificial të Tiranës dhe në mënyrë të vecante në sistemin e shkarkimit të saj të kërkuara nga KKDM me synimin e venies në funksion të plote sipas kërkesave teknike. Bazuar tek legjislacioni në fuqi, Projekti duhet të miratohet në KKDM.
- Informacion për Investimet e parashikuara në digat e mëdha nga Bashkia Tirane.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në Vendim sipas legjislacionit në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

